

Në bazë të nenit 28 paragrafi 2 pika 3, nenit 70 paragrafi 7 të Ligjit për kulturë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18), Aktvendimit nr. UP1 32-774/2025 të datës 17.02.2026 të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit dhe Vendimit nr. 02-139/3 të datës 02.03.2026 të Bordit Drejtues të IN Qendra e Konservimit – Shkup, sjell këtë:

PROGRAMIVJETOR

PËR PUNË DHE FINANCIM TË IN QENDRA KONSERVATORE – SHKUP NË VITIN 2026

IN Qendra Konservatore – Shkup, në vitin 2026 do t’i realizojë projektet në vijim me interes nacional në kulturë.

Nga fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të paluajtshme:

1. Realizimi i Projektit për konservimin dhe restaurimin e 40 ikonave dhe ikonostasit në kishën Shën Spasi, Shkup..... 150.000,00 den.
2. Realizimi i Projektit për sigurimin fizik të institucionit me angazhimin e dy personave nga Agjencia për sigurim..... 1.000.000,00 den.
3. Realizimi i Projektit kryesor për punë konservuese-restauruese në Akuaduktin e Shkupit1.800.000,00 den.
4. Realizimi i Projektit kryesor për konservimin dhe restaurimin e shtëpisë së Llazar Liçenovskit dhe Projektit kryesor për sanimin e pjesëve nëntokësore të shtëpisë së Llazar Liçenovskit në Shkup..... 1.500.000,00 den.
5. Realizimi i fazës së parë të Projektit kryesor për intervenime konservuese-restauruese në objektin Salla e sporteveve nga kompleksi i Postës në Shkup 2.000.000,00 den.
6. Përpilimi i Projektit kryesor për rivitalizimin e Monumentit të kulturës Kalaja e Shkupit.....300.000,00 den.
7. Servisimi i pajisjeve kundër zjarrit, kontrolli i sistemit për zbulim dhe lajmërim automatik të zjarrit dhe lëshimi i dokumentit, si dhe matja e tokëzimit mbrojtës dhe matja rrufepritëse dhe lëshimi i dokumentit.....150.000,00 den.

ARSYETIM

Në bazë të Propozim-programit për punë të IN Qendra Konservatore– Shkup, në vitin 2025, i cili u dorëzua në Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit dhe Raportit të Komisionit për trashëgimi kulturore të paluajtshme dhe mbrojtje të të mirave audiovizuale, ministri i Kulturës dhe Turizmit solli Aktvendimin nr. UP1 32-774/2025 të datës 17.02.2026 (numri ynë 03-132/1 i datës 19.02.2026).

Pas marrjes së pëlqimit nga Bordi Drejtues i IN Qendra Konservatore – Shkup me Vendimin nr. 02-139/3 të datës 23.02.2026, si dhe në bazë të asaj që u tha më lart, u.d. drejtori solli Programin vjetor për punë dhe financim të IN Qendra Konservatore– Shkup në vitin 2026.

U.D.DREJTOR,

dia, Liljana Kitanovska
konservatore -këshiltare